



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2020
Nr. ref.:RK 1513/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. 104/19

Parashtrues

“Ena”

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ruzhdi Kumnova, i cili pretendohet të jetë përfaqësues i fabrikës “Ena” (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

Vendimi i kontestuar

2. Përfaqësuesi i pretenduar konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin përfaqësuesi i pretenduar pretendon se fabrikës “Ena” i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe me nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2019, përfaqësuesi i pretenduar e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
7. Më 29 korrik 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të dorëzojë autorizimin që dëshmon se përfaqësuesi i pretenduar e përfaqëson fabrikën “Ena” në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 21 tetor 2019, Gjykata i dërgoi sërish shkresë përfaqësuesit të pretenduar dhe kërkoi nga ai që autorizimin e kërkuar me shkresën e 29 korrikut 2019 si dhe plotësimin e formularit për kërkesat individuale t'i dorëzojë në Gjykatë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh. Gjykata në dy raste ka kërkuar nga përfaqësuesi i pretenduar që të dorëzojë dokumentet e lartcekura por ai nuk ka vepruar në pajtim me kërkesat e Gjykatës. -

9. Më 16 janar 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Gjykata nuk i referohet fakteve të këtij rasti, pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar, i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizim për të parashtruar këtë kërkesë në emër të fabrikës “Ena”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Duke qenë se kërkesa është parashtruar nga një parashtrues i cili nuk ka sjellë autorizim para Gjykatës, kjo e fundit nuk do të përmend pretendimet që supozohet se i përkasin fabrikës “Ena” në mungesë të një autorizimi formal për të bërë një gjë të tillë.

Pranueshmëria e kërkesës

12. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafët 1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

14. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili parashikon:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili specifikon:

“[...]

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; [...].

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm”.

16. Gjykata rikujton që kërkesa është dorëzuar nga R. K. i cili pretendon të jetë i autorizuar për të përfaqësuar fabrikën “Ena”. Gjykata vëren se R. K. nuk ka bashkëngjitur në shkresat e lëndës një autorizim të vlefshëm për Gjykatën.
17. Gjykata gjithashtu rikujton se kishte kërkuar dy herë nga përfaqësuesi i pretenduar që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin përkatës të vlefshëm, por ai nuk iu ishte përgjigjur kërkesave të Gjykatës të përmendura me anë të shkresave të 29 korrikut dhe 21 tetorit 2019.
18. Gjykata më tej vëren se, me shkresën e 29 korrikut 2019 dhe me shkresën e 21 tetorit 2019, përfaqësuesi i pretenduar kishte pranuar informatat siç duhet për nevojën e dorëzimit të autorizimit për përfaqësim në Gjykatë.
19. Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullit 32 të Rregullores së punës.
20. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson para Gjykatës (shih rastet e Gjykatës nr. KI23/18, parashtres, *Ismet Kërçagu*, si përfaqësues i pretenduar i A. K., M. K., B. K., F. K. dhe A. K., Vendim për refuzim të kërkesës, i 7 shkurtit 2019; nr. KI16/18, parashtres, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i K. N., Vendim për refuzim të kërkesës, i 31 dhjetorit 2018; nr. KI30/18, parashtres, *Sahit Musa*, si përfaqësues i pretenduar i N. H., XH. H. dhe S. H., Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 majit 2018; dhe rastin KI203/18, parashtres, *Afrim Salihu* si përfaqësues i pretenduar i L. K., Vendim për refuzim të kërkesës, i 26 qershorit 2019).
21. Gjykata dëshiron të theksojë se është e domosdoshme që përfaqësuesit të dëshmojnë se ata kanë marrë udhëzime specifike dhe të qarta për përfaqësim të viktimës së pretenduar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës (shih rastin, *Angelique Post kundër Holandës*, kërkesa nr. 21727/08 GJEDNJ, Vendimi i 20 janarit 2009).
22. Në dritën e këtyre fakteve, Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...] (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. [...]”.
23. Gjykata konsideron se përfaqësuesi i pretenduar nuk ka ofruar informata dhe nuk ka dorëzuar dokumente siç i ishte kërkuar nga Gjykata.

24. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në rregullin 35 (5) të Rregullores së punës konstaton se kërkesa e përfaqësuesit të pretenduar duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 47.1 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 16 janar 2020, njëzëri


VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi